

Titull: Të Sjellshëm ose Pasjellshëm

Qëllimi:

Ky ushtrim i predispozon fëmijët të marrin parasysh faktin se i njëjti veprim mund të perceptohet si i mirë ose jo në varësi të kontekstit dhe qëllimit.



Prezantimi:

Mirësia mund të jetë më e thellë dhe kuptimplotë se fjala “të lutem” apo “faleminderit”. Por shpeshherë mund të ndihemi konfuzë nëse/kur veprimet tona keqkuptohen. Si mund të tregojmë mirësi? Si mund t’i shprehim qartë qëllimet tona për të bërë mirë apo ndihmuar të tjerët?

Burimet:

Filxhan/Kapele
Letra të vogla
Lapës/Stilolapës/Markersa

Udhëzime:

Përzgjidhni disa apo të gjitha materialet që i shihni si më të përshtatshme për fëmijët. Ju mund t’i shkruani këto veprime apo bëma në copat e letrave, t’i fusni në kapele apo filxhan dhe fëmijët të zgjedhin ose ju mund të përzgjidhni disa që t’i lexoni me zë të lartë e diskutoni.

Personi që e zgjedh letrën, do t’i përgjigjet pyetjes : “ Kur e ke perceptuar këtë veprim si të mirë/xhest mirësie?” Dikush tjetër d t’i përgjigjet pyetjes së kundërt, pra : “Kur e ke perceptuar këtë veprim si jo të mirë?” Nëse nuk e kanë përjetuar personalisht atë çka thuhet në letër, mund të japin një përgjigje të bazuar në një histori hipotetike .

Vazhdoni derisa t’i mbaroni të gjitha materialet , më pas vazhdoni diskutimin si në vijim.

Diskutim:

Çfarë e bën diçka të mirë ose jo? Si e kuptoni nëse dikush po tregohet i sjellshëm ose jo?

Si mund ta kuptosh nëse ti po tregohesh i sjellshëm apo jo?

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që duhet t’i mbajmë mend rreth të qenit i sjellshëm?

Mund të rikujtoni një rast ku jeni munduar për të qënë i sjellshëm, por keni bërë të kundërtën? Çfarë do të bëje ndryshe herën tjetër?

Tashmë që zotëron pikëpamje të reja rreth mirësisë e të qenurit i sjellshëm, si mund ta ndash eksperiencën tënde me të tjerët?



**POP-UP
FESTIVAL**